



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
SEKTORI I BUJQËSISË

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ Datë ____ / ____ /2025

Miratimi i sipërfaqeve të tokave bujqësore që do të jepen me qera nga Bashkia Kolonjë

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, ligjit nr. 8312 date 26.03.1998 “Për tokat e pandara” si dhe udhezimit nr. 1 datë 18.07.2012 “Për procedurën e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara” pika 2, për pasuritë që do jepen me qera nga ana e bashkisë Kolonjë.

Nr.	Nr. i ngastrës	Nr. Pasurise	Sipërfaqja (ha)	ZK	Vëndi
1	610	610	1.93	3083	Qafzes
2	615	615	1.21	3083	Qafzes
3	778	778/24	1.4035	3557	Taç Lart
4	1283	1283/4	5.7402	1757	Gjonç

VENDOSI

1. Të miratojë pasuritë e mësipërme për tu dhene me qera.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural pranë Bashkisë për ndjekjen e procedurave.
3. Ky projekt-vendim hyn në fuqi pas miratimit nga prefektura.

Për Sektorin e Bujqësisë

DREJTORI

Konceptoi: Olgert MAILI

Ganiart EMINAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
SEKTORI I BUJQËSISË

Nr 1983 Prot

Ersekë më 22/04/2025

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIMIN
NR. _____ DATË ____/____/2025

PËR DHËNIEN ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE

Në bazë të Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 Bashkia Kolonjë ka rolin e administratorit për sipërfaqet të cilat ndodhen brenda hapësirës së saj teritoriale.

Udhëzimi nr 1, datë 18.07.2012 ka përcaktuar në mënyrë eksplicite procedurën ligjore që duhet të ndiqet për dhënien me qira të tokave bujqësore nga ana e pushtetit vendor. Në zbatim të pikës Nr.2, Sektori i Bujqësisë pranë Bashkisë evidenton sipërfaqet e tokës bujqësore për dhënien me qira, me tregues të tillë për evidentimin (nr. pasurie,sipërfaqe,vendndodhje (ose zonë kadastrale)dhe konkretisht: Nga verifikimet e kryera nga ana jone rezulton se këto pasuri në regjistrat e pasurisë së paluajtshme kanë statusin juridik “shtet”,nuk kanë asnjë kufizimin në seksionin “ E” të kartelës, pra nuk janë në fond kompensimi per Agjensise e Kthimit dhe Kompesimit te Pronave per ish-pronaret.

Në bazë të informacionit të siguruar nga DAMT-ja Këshilli i Qarkut Korçë këto pasuri kanë qënë në përbërje të ish-Kooperativave Bujqësore (pra nuk ka qënë në përbërje të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore)

Si përfundim duke qënë se pasuria nr. 610 me sip. 19300 m² (1.93 ha) Zona Kadastrale 3083, fshati Qafzes, pasuria 615 me sip. 12100 m² (1.21 ha) Zona Kadastrale 3083, fshati Qafzes, pasuria 778/24 me sip. 14035 m² (1.4035 ha) Zona Kadastrale 3557, fshati Taç Lartë, pasuria 1283/4 me sip. 57402 m² (5.7402 ha) Zona Kadastrale 1757, fshati Gjonç i përmbushin të gjitha kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, i propozojme Këshillit të Bashkisë Kolonjë në përputhje me kompetencat që i ka dhënë ligji nr. 139/2015, neni 54 i tij miratimin e dhënies me qira të pasurisëve te mesiperme dhe më pas vazhdimin e procedurave ligjore per konkurim nepermjet shpalljes në ankand.

Për Sektorin e Bujqësisë
Konceptoi: Olgert MAILI

KRYETARI
ERION ISAI

DREJTORI
Miratoi: Ganiart EMINAJ

K-34-126-(181)

K-34-126-(180)





